



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 27.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas tri **kërkesave për ri-shqyrtim** të datës **18.03.2024**, të parashtruar nga operatorët ekonomik sipas projekteve me shifrat: **1412** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime”** me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik sipas projektit me shifren 1412 të dt. 18.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime”** me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, kundër NJOFTIMIT PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT - REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK të datës 11.03.2024 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet**, NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT i datës 11.03.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatorët Ekonomik me shifren 1412, me datë 18.03.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime”** me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3. Autoriteti Kontraktues, me datën 26.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

- Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e transparencës
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 Kriteret për dhënien e kontratës
- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik

Neni 20 Specifikimet Teknike

Neni 41 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet - Pretendimet ankimore te OE ankues:

SQARIM:

Ky aktivitet i prokurimit është stërzgatur për shkak të vlerësimeve jo reale dhe jo të drejta të AK-së. Në lidhje me vlerësimin e parë, ne kishim parashtruar ankesë në OSHP dhe ekziston vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0616 dt.13.10.2023 i cili kishte konstatuar shkelje ligjore dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim.

Gjatë rivlerësimit të projekteve ideore Juria Profesionale kishte dhënë vendimin e saj ku ne jemi listuar si të parët me gjithsejt 89.8 pikë.

Në lidhje me këtë rivlerësim si pale e pakënaqur OE me kodin 8485 tashme me identitet të zbuluar PROARCHITECTURE SH.P.K. kishte dorzuar Ankesë në OSHP dhe me datë 01.02.2024, OSHP merr Vendim që lënda të kthehet përsëri në rivlerësim pasi që Ankesa e OE është pjesërisht e bazuar.

Gjatë rivlerësimit të tretë është vazhduar me të njëjten tendencë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të AK-së ku ne jemi vlerësuar me 58.77 pikë (Vendi i Dytë) ndersa OE me kodin 8485 është vlerësuar me 81.06 pike e kjo tregon edhe njëher se vlerësimi është bërë krejtësisht në mënyr subjektive dhe joreale duke u munduar që të krijoj një diferenc të lartë ne mes vendit të parë me të dytin me të vetmin qëllim që ne si OE mos të shpallemi fitues të këtij AP pasi që jemi i vetmi OE që kemi plotësuar në tërësi kërkesat e AK-së.

Edhe në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike që ne kemi bërë me datë 12.03.2024 ku kemi kërkuar Raportin e Komisionit Vlerësues dhe dokumente tjera, AK na ka dhënë Raportin e Komisionit Vlerësues me pikët e dhëna nga ky komision, mirëpo nuk kemi pranuar komentet e antarëve të komisionit për ta kuptuar se nga janë bazuar në pikët e dhëna për secilin kriter. Ne dyshojmë së antarët e komisionit nuk e kanë pasur fare parasysh Detyren Projektuese dhe poashtu mendojmë se janë po të njëjtit anëtar që kanë qenë pjesë e Komisioneve Vlerësuese të mëparshme gjë që është në kundërshtim me LPP-në dhe poashtu vlerësimi i tyre në mes vete ka një diskrepancë të madhe të pikëve gjë që tregon edhe një vlerësim tendencioz dhe subjektiv.

Ky vlerësim i AK-së është shumë subjektiv, i njëanshëm dhe joprofesional sepse ne, në pothuajse të gjitha kriteret i plotësojmë me pikë maksimale.

Është absurditet se si tek Kriteri Hapësinor tek i cili kriter ne nuk kemi bërë pothuajse asnjë shkelje të Detyres Projektuese njëri anëtar i komisionit vlerësues na jep 13.6 pike, tjetri anëtar 14.2 kurse anëtarit tjetër na poenton me 36.2 pikë nga 40 pike maksimale sa kanë qenë në këtë kriter. Ky dallim në pikë ne mes të anëtareve të komisionit vlerësues tregon edhe njëher se sa tendencioz dhe subjektiv ka qenë vlerësimi i anëtareve të komisionit.

Tek nën kriteri Paraqitja Grafike dhe Teknike e Projektit ne kemi marrë nga 5 respektivisht 6 pikë nga dy anëtar të jurisë profesionale ndërsa nga anëtarit tjetër i jurisë kemi marrë 40 pike gjë që tregon një mosvlerësim të drejt dhe profesional.

Kësi raste të vlerësimit skandaloz kemi edhe tek kriteret tjera si Kriteri Programor, Kriteri Ekonomik, Kriteri i Lëvizshmërisë dhe Kriteri Estetik dhe Ekologjik – Ark. e Qëndrueshme ku në të gjitha rastet ka një vlerësim jo korrekt e poashtu dallim të madhe në pikë ne mes të anëtareve të Jurisë Profesionale.

Në vazhdim, po i prezentojmë argumentet tona, të cilat dëshmojnë se vlerësimi i Jurisë Profesionale të caktuar nga MINISTRIA E SHËNDETËSISË lidhur me këtë konkurs projektimi është i paqëndrueshëm profesionalisht dhe ligjrisht dhe në kundërshtim të plotë me Detyrën Projektuese.

Argumenti 1:

Mosrespektimi i rregullativës ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe kriterëve hapësinorë sic janë paraparë në detyrën projektuese dhe specifikat teknike nga ana e projekteve pjesëmarrëse në konkursin e projektimit

Bazuar në Detyrën Projektuese të "Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime", nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK- Ministria e Shëndetësisë kërkon që "Distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. 1h (h=lartësia bruto e objektit mbi parter) dhe Planifikimi i objektit duhet të bëhet duke i marr parasysh qasjen vetem nga rruga "Tahir Sinani".

Po ashtu në Detyrën Projektuese, AK- Ministria e Shëndetësisë si informatë shtesë është potencuar dhe kërkon nga të gjithë projektuesit pjesëmarrës që:

"..kompania projektuese duhet të konsultoj planifikimet urbane të Komunës së Shtimes dhe legjislacionin tjetër në fuqi për hapësirat dhe koeficientet e lejuar brenda sipërfaqes së përgjithshme të lokacionit të përcaktuar".

Siç vërehet qartë, projekti ideore me shifrën 8485 nuk ka respektuar këto kriterë dhe obligimet ligjore që kanë të bëjnë me planifikim hapësinor dhe detyrën projektuese, poashtu nuk kanë respektuar Nenin 20.9 Specifikimet Teknike të RRUOP-së për arsye se:

- Projektuesi me shifrën 8485 në projektin e tij në fletën ku është paraqitur dhe dimensionuar situacioni, nga ana perëndimore e parcelës megjithëse kërkohet minimum të largohet nga pacela fqinjë 8.4m, ai është larguar 5.18 në njëren pikë dhe 7.45 në pikën tjetër, ndërsa në anën veriore do duhej të largohej min. 12.6m ai është larguar 9.19m, që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe detyrën projektuese ku kërkohet që: "Distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. 1h (h=lartësia bruto e objektit mbi parter)".

Edhe përkunder se Projekti me shifrën 8485 ka shkelur të gjitha distanacat e objektit karshi parcelës serish Komisioni Vlerësues i Projekteve tek Kriteri Hapësinorë e ka poentuar me pike maksimale (31.86 pikë) nga 40 maksimale, ndërsa projektin me shifrën 1412 edhe pse i ka respektuar në tërësi kriteret hapësinorë sipas detyrës projektuese marre (21.33 pikë) .

Për Argumentin 1 kemi edhe kontaktimin e Ekspertit Teknik të OSHP-së Psh.nr.621/23 i cili citon se pretendimi i ngritur nga ana jonë është i bazuar.

Me këto veprime të paligjshme, Juria Profesionale ka shkelur edhe nenin 41.3 të RREGULLAVE dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK, ku thuhet se "Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuar" si dhe pikën 41.5, pika b të këtyre Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik ku thuhet se "Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur: është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit.

Argumenti 2:

Mosrespektimi i Detyrës Projektuese, specifikave teknike dhe kriterëve profesionale të projektimit të ndërtesave shëndetsore

Bazuar në Detyrën Projektuese të "Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime", nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK- Ministria e Shëndetësisë kërkon dhe paraqet kërkesa shumë specifike që nuk janë respektuar nga projekti me shifrën 8485

Në Detyrën Projektuese tek kapitulli VIII "NDËRTIMI I QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE DHE SHËRBIMEVE URGJENTE NË SHTIME" nga faqe 18 deri në faqe 26 të dosjes së tenderit janë paraqitur kërkesat e detyrës projektuese të cilat do duhet të respektohen nga OE. Siç vërehet qartë, projektet ideore me shifrën 8485 nuk ka respektuar këto kriterë dhe obligime të detyrës projektuese dhe specifikat teknike të kerkuara për arsye se:

- Projektuesi me shifrën 8485 nuk ka respektuar detyrën projektuese dhe specifikat teknike të kerkuara ku kërkohet:

Dhoma e triazhimit me min. dy krevate - 40 m², projekti në fjalë e ka paraparë këtë hapësirë si pjesë të koridorit të urgjencës e jo dhomë sic e kërkon detyra projektuese.

Hyrja e veçantë në zonën e mjeksis familjare – erembrojtjesi hyres 15m², projekti në fjalë e ka paraparë këtë hapësirë me sipërfaqe 10m², në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Mjekësia Familjare Nyjet sanitare - 3 për pacient M(1)/F(2) (tualeti për meshkuj të ketë min. 2 pisuar), në afërsi të ketë dhe një WC për persona me aftësi të kufizuara, projekti në fjalë e ka paraparë vetëm 1 tualet për femra, në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Mjekësia Familjare Nyjet sanitare për personel, M(1)/F(1), tualeti për meshkuj (M) të ketë së paku një pisuar, projekti në fjalë nuk e ka paraparë 1 pisuar tek tualeti për meshkuj, në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Objekti i QKMF-se duhet të ketë max. 4 +1 hyrje ((sherbimi ambullantor; urgjenca; personeli dhe ekonomike) + Hyrja në diagnostikë – si mundësi shtese). Duhet të parashifet edhe një hyrje për rastet e jashtëzakonshme (hyrja 5) për raste të veqanta për qasje në zonën e vaksionimit, projekti në fjalë ka paraparë gjithësej 7 hyrje në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te pjesa e laboratorit ... një hapësirë për mirmbajtje hixhenike, projekti në fjalë nuk e ka paraparë fare këtë kthinë, në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Hapsirat për edukim dhe promovim shëndetësor Tuatele për staf dhe mysafir M(1)/F(2)/1(handicap) + dy pisuar për (M), projekti në fjalë e ka paraparë vetëm 1 tualet për femra, në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Edhe përkunder se Projekti me shifrën 8485 ka shkelur të gjitha pikat e cituara si më lartë Komisioni Vlerësues i Projekteve tek Kriteri Programor e ka poentuar me pike maksimale (18.30 pikë) nga 20 maksimume, gjë që është në kundërshtim të plotë me Kriterin Programor të dhënë në Detyrën Projektuese dhe tregon se sa subjektive dhe tendencioze ka qenë Juria Profesionale.

Për Argentin 2 kemi edhe kontaktimin e Ekspertit Teknik të OSHP-së Psh.nr.621/23 i cili citon se pretendimi i ngritur nga ana jonë është i bazuar.

Me këto veprime të paligjshme, Juria Profesionale ka shkelur edhe nenin 41.3 të RREGULLAVE dhe UDHËZUESIT OPERATIV PËR PROKURIMIN PUBLIK, ku thuhet se "Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara" si dhe pikën 41.5, pika b të këtyre Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik ku thuhet se "Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur: është në pajtueshmëri në termet teknike me përshtkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit.

Argumenti 3:
Mosrespektimi i Detyrës Projektuese dhe dispozitat ligjore të RREGULLORES Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA;

Bazuar në Detyrën Projektuese të "Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime", nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK- Ministria e Shëndetësisë kërkon në detyrën projektuese "Shkallë për evakuim emergjent (kunder zjarrit)..." ndërsa të njëjtat edhe pse janë paraqitur në pjesën grafike të projekti me shifrën 8485 ai përsëri nuk ka menduar dhe projektuar si duhet kështu ka bërë shkelje të rregulloreve të përgjithshme.

Duke u bazuar në "RREGULLOREN Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA" vërehet qartë se, projekti ideore me shifrën 8485 ka shkelur:
Neni 21 1. Hapësira e shkallëve duhet të ketë hapje për ajrosje natyrore, të cilat hapen nga kati përderisose ose nga pushimoret në shkallë.

Neni 32 3. Të gjitha daljet nga objekti duhet të qojnë drejtpërdrejtë në rrugë, oborr ose në ndonjë hapësirë të sigurt.

Neni 33 2. Dyert duhet të jenë të vendosura në mënyrë që në çdo kohë mund të hapen nga ana e cila duhet të dalim.

Edhe përkunder se Projekti me shifrën 8485 ka shkelur të gjitha pikat e cituara si më lartë Komisioni Vlerësues i Projekteve tek Kriteri i Lëvizshmërisë e ka poentuar me pike maksimale (8.16 pikë) nga 10 maksimume, gjë që është në kundërshtim të plotë me Kriterin e Lëvizshmërisë të dhënë në Detyren Projektuese dhe Normat teknike për mbrojtje nga zjarri.

Prandaj, dëshkohet qartë se duke vlerësuar me pikë maksimale konceptin projektin me shifrën 8485 siç dëshmuam më lartë nuk ka respektuar SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME të Dosjes së Konkursit të Projektimit për këtë aktivitet prokurimi, Juria Profesionale e caktuar nga AK-Ministria e Shëndetësisë ka shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, përkatësisht pikën 4 të këtij neni ku kërkohet decidivisht që *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*.

KONKLUZION

Si konkluzion mund të thuhet se Juria Profesionale e caktuar nga MINISTRIA E SHËNDETËSISË përmes mosvlerësimit të drejtë të projekteve pjesëmarrëse në këtë konkurs projektimi, duke na diskriminuar neve si OE pjesëmarrës në këtë konkurs projektimi dhe duke shpallur fitues dhe vlerësuar me pikë maksimale projektin që nuk ka respektuar kërkesat e Detyrës projektuese dhe rregullativën ligjore në fuqi, ka shkelur rëndë dispozitat ligjore të LPP-së.

Është e papranueshme për ne kjo diskrepancë e pikëve të dhëna nga Juria Profesionale kur dihet qartë se për të njëjtën lëndë janë dhënë edhe mendimet e ekspertëve teknik të OSHP-së të cilët kanë vlerësuar se nuk mund të jepen pikë maksimale aty ku ka shkelje substanciale të Detyrës Projektuese e që një gjë të tillë e ka bërë kjo Juri me këtë mosvlerësim të drejtë. Diskrepancë të lartë ka edhe në mes të anëtarëve të Jurisë në mes vete e poashtu edhe nga vendi i parë me atë të dytë, gjë që tregon një anomali e poashtu mosvlerësim të drejtë.

Prandaj, duke pasur parasysh se vendimi i AK-së lidhur me këtë konkurs projektimi është i paqëndrueshëm ligjërisht dhe profesionalisht, dhe duke pasur parasysh poashtu se projekti me shifrën 8485 bazuar në mosrespektimin e kërkesave të Detyrës Projektuese dhe Nenit 20.9 Specifikimet Teknike sipas RRUOP të këtij konkursi projektimi dhe rrjedhimisht edhe të rregullativës ligjore në fuqi, është projekt i papërgjegjshme.

Më këto veprime, AK- MINISTRIA E SHËNDETËSISË ka shkelur dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik lidhur me vlerësimin e pavarur dhe të drejtë e të barabartë, përkatësisht këto nene të LPP-së:

AK ka shkelur dispozitat e LPP në
Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo - Diskriminimi
Neni 10 Mjetet për promovimin e transparencës
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve
Neni 60 Kriteret për dhenjen e kontratës

AK ka shkelur edhe dispozitat e RREGULLAVE dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK:

20. Specifikimet Teknike
41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "N.N.SH" Vizion Project
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (formulari B58) dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i projekteve të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te OE ankues:

E kemi shqyrtuar kerkesen per rishqyrtim te OE me shifren 1412 dhe konstatojme se pretendimet ankimore jane te pa bazuara dhe bazuar ne venimin e OSHP-se me nr. 2023-0966, AK-MSh konsideron se projekti juaj ka mundur edhe te diskualifikohet si i pa pranueshem.

OE ankues e konteston profesionalizmin e jurise si dhe dallimet ne poena te vleresimeve ne mes anetareve te jurise, por ky nuk eshte ndonje argument bindes per arsyetimin e pretendimeve te ankeses, perkundrazi per AK-MSh vleresimi i bere nga dy inxhinieret e MSH-SHSHKUK eshte me i besueshem meqense eshte i balancuar, krahasuar me anetarin nga K.K. Shtime i cili e ka vleresuar me me shume poena projektin 1412.

Për këtë aktivitet është dhënë Vendimi i OSHP-se me nr. 2023-0966 sipas te cilit nuk është përkrahur Vendimi i AK-MSh kur e kemi përzgjedhur si fitues projektin me shifren 1412 dhe sipas ketij vendimi lenda eshte kthyer ne rivleresim.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues te OSHP-se për pretendimet ndaj projektit 1412:

Konstatimi i parë (I): Nuk është respektuar distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. 1h nga kufirin i parcelës veriore. (h=lartësia bruto e objektit mbi parter) te bazuar në Detyrën Projektuese të dhënë nga AK”.

Pretendimi për paraqitje të gabuar-devijuar te parcelës kadastrale, respektivisht e ka paraqitur parcelën kadastrale 00006-3 me te madhe se sa është zyrtarisht, kjo paraqitje lajthitëse e parcelës kadastrale është bërë në kufirin kadastral përgjatë rrugës magjistrale “Tahir Sinani”, me ç ‘rast është zgjeruar ky përgjatë tërë gjatësisë se tij përreth 11 metra. Në këtë mënyrë, Operatori Ekonomik 1412 me apo pa qëllim, i ka ndryshuar të dhënat reale të parcelës kadastrale 00006-3, ne mënyrë që ta realizoj një formë të objektit, të cilën realisht nuk e zë fare kjo parcele.

Konstatimi 4: Projekti 1412 e ka tejkaluar sipërfaqen e kërkuar të detyrës projektuese. Në DT është përcaktuar se objekti do te ketë sipërfaqe minimale Bruto (sipas sqarimeve shtesë për OE, datë 06.06.2023) prej 2800m2 (ose) maksimale prej 3000 m2, me etazhitet max B+P+1.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues te OSHP-se:

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe teknik dhe mendimi i atij teknik janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e saj me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertizës, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertizës. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Sa i përket pretendimeve për vlerësimin e me 21.33 pike për kriterin hapësinore, kjo është bere bazuar ne konstatimet e bëra nga OSHP ne lidhje me mosrespektimin e distancave dhe parcelës kadastrale. Pjesërisht pajtohem me disa pretendime, për disa mangësi edhe te projektit 8485 dhe ato janë cekur edhe ne vlerësimin e fillestar, por këto mangësi janë me te vogla se sa te projekteve tjera konkurruese, andaj AK-MSh me qëllimin me te mire për realizimin e këtij projekti investiv, ka përzgjedhur projektin 8485 si me te kompletuarin ne mesin e projekteve ne këtë gare.

Defektet e evidentuara janë trajtuar si jo substanciale dhe te cilat do te korrigojohen gjate projektimit final.

Bazuar ne sqarimet e dhëna nga Juria e pavarur qe ka bere rivlerësimin e projekteve, ZPP bazuar ne legjislacionin e prokurimit ne fuqi, ju njofton se pretendimet e juaja te paraqitura ne kërkesat për rishqyrtim janë te pa bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit